

ALBTELECOM SH. A.	
Drejtori	Përzjithshme
NR 1695	PROT
DATE	30.3.2012

## Pasqyrat Financiare te Shoqerise

“Albtelecom” sh.a.

Per periudhen Janar- Dhjetor 2011



Tirane, me 30 Mars 2012

## VERTETIM

Shoqeria jone eshte emeruar per te kryer auditimin e pasqyrave financiare te shoqerise ALBTELECOM SHA me NIPT J61824053N per vitin 2011. Ne jemi duke kryer procesin e auditimit ne zbatim te SNA. Ne nuk e kemi perfunduar ende auditimin dhe ne kete moment nuk mund te leshojme raportin perfundimtar te auditimit.


E leshojme kete vertetim per tu paraqitur si pjese e dokumentacionit qe shoqeron pasqyrat financiare te shoqerise ne Degen se Tatim Taksave.

Me respekt,



**GJINI**  
CONSULTING  
REGISTERED AUDITORS

Teit Gjini  
Ekspert Kontabel i Regjistruar



Diana Ylli (Golemi)  
Ekspert Kontabel i Regjistruar



Shpresa Brecani  
Ekspert Kontabel i Regjistruar



PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR .....	1
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR ( Vazhdim) .....	2
PASQYRA E TE ARDHURAVE GJITHEPERFSHIRESE .....	3
PASQYRA E CASH FLOW .....	4
PASQYRA E LEVIZJES SE KAPITALEVE TE VETA .....	5
SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE .....	6
1. Informacion i Pergjithshem .....	6
2. Baza e pergatitjes se pasqyrave Financiare .....	7
3. Permbledhje e politikave te rendesishme kontabile .....	7
4. Mjete Monetare .....	16
5. Llogarite e arketueshme Afatshkurtra .....	16
6. Inventari .....	19
7. Shpenzime te paguara ne avance: .....	19
8. Investime Financiare ne Pjesemarrje .....	19
9. Aktivet Afat Gjata Jo Materiale, AAJM .....	20
10. Aktive Afat Gjata Materiale .....	21
11. Llogari te Arketueshme Afat Gjata .....	22
12. Huate dhe Interesat Bankare .....	22
13. Llogari te Pagueshme ndaj Furnitoreve .....	23
14. Te tjera Llogari te Pagueshme .....	24
15. Detyrimet Tatimore .....	25
16. Kapitali .....	25
17. Rezervat .....	26
18. Te Ardhurat .....	26
19. Te Ardhura te tjera rrjedhese .....	26
20. Shpenzimet te veprimtarise kryesore .....	27
21. Shpenzime personeli dhe shpenzime te tjera rrjedhese .....	27
22. Rezultati Financiar Neto .....	28
23. Rezultati Tatimor .....	28
24. Transaksionet me palet e Lidhura .....	28
25. Instrumentat Financiare Manaxhimi i Riskut Financiar .....	29





**PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR**  
Per ushtrimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2011

(Shumat jane shprehur ne mije leke)

<b>AKTIVET</b>	<b>Shenime</b>	<b>31.12.2011</b>	<b>31.12.2010</b>
<b>Aktive afatshkurtra</b>			
Mjete monetare	4	156,772	1,428,705
Kerkesa te arketueshme	5	3,154,166	2,447,085
Inventari	6	333,356	436,875
shpenzime te periudhave te ardhshme	7	127,851	167,150
<b>Totali i aktiveve afatshkurtra</b>		<b>3,772,144</b>	<b>4,479,816</b>
<b>Aktive afatgjata</b>			
Investime ne pjesemarrje	8	5,494,315	5,494,315
Aktive afatgjata materiale	10	19,495,815	18,817,238
Aktive afatgjata jomateriale	9	3,398,979	3,399,458
Kerkesa te arketueshme	11	143,838	157,940
<b>Totali i aktiveve afatgjata</b>		<b>28,532,946</b>	<b>27,868,952</b>
<b>TOTALI I AKTIVEVE</b>		<b>32,305,090</b>	<b>32,348,768</b>

Shenimet shoqeruese jane pjese integrale e ketyre pasqyrave financiare.



*[Handwritten signature]*

**PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR ( Vazhdim)**  
**Per ushtrimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2011**

(Monedhat jane shprehur ne mije leke)

<b>PASIVET DHE KAPITALI</b>	<b>Shenime</b>	<b>31.12.2011</b>	<b>31.12.2010</b>
<b>Pasive afatshkurtra</b>			
Hua	12	2,859,584	2,075,841
Te pagueshme ndaj furnitoreve	13	1,693,963	1,901,515
Te tjera llogari te pagueshme	14/15	500,167	465,249
<b>Totali i pasiveve afatshkurtra</b>		<b>5,053,714</b>	<b>4,442,605</b>
<b>Pasive afatgjata</b>			
Hua	12	7,784,013	10,543,963
Te pagueshme ndaj furnitoreve	13	1,386,384	
<b>Totali i pasiveve afatgjata</b>		<b>9,170,396</b>	<b>10,543,963</b>
<b>Kapitali</b>			
Kapitali aksioner	16	15,000,000	15,000,000
Rezerva	17/1	2,362,200	1,159,031
Rezultati i ushtrimit	17/2	718,780	1,203,169
<b>Totali i kapitalit</b>		<b>18,080,980</b>	<b>17,362,200</b>
<b>TOTALI I PASIVEVE DHE KAPITALIT</b>		<b>32,305,090</b>	<b>32,348,768</b>

*Shenimet shoqeruese jane pjese integrale e ketyre pasqyrave financiare.*



## PASQYRA E TE ARDHURAVE GJITHEPERSHIRESE

Per ushtrimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2011

(Shumat jane shprehur ne mije leke)

Pershkrimi	Shenime	31.12.2011	31.12.2010
<b>Shitjet neto</b>	18	9,185,102	10,116,654
Kosto e sherbimeve te shitura	20	(4,134,713)	(4,431,145)
<b>Fitimi bruto</b>		5,050,389	5,685,509
Shpenzime te pergjithshme dhe administrative	21	(3,529,110)	(3,862,411)
<b>Fitimi nga veprimtaria e shfrytezimit</b>		1,521,279	1,823,098
Te ardhura te tjera	19	46,714	50,911
Te ardhurat dhe shpenzimet financiare	22	(628,622)	(356,386)
<b>Fitimi/humbja para tatimit</b>		939,371	1,517,623
Shpenzimet e tatimit mbi fitimin	23	(220,592)	(314,454)
<b>Fitimi/humbja neto e vitit financiar</b>		718,780	1,203,169
Te tjera te ardhura gjithepershires			
Te tjera te ardhura gjithepershires		--	--
<b>Totali i te ardhurave gjithepershires</b>		718,780	1,203,169
Totali i te ardhurave gjithepershires te percaktuara per:			
Aksioneret		718,780	1,203,169
<b>Totali i te ardhurave gjithepershires</b>		718,780	1,203,169

Shenimet shoqeruese jane pjese integrale e ketyre pasqyrave financiare.



*[Handwritten signature]*

3



## PASQYRA E CASH FLOW

Per ushtrimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2011

(Shumat jane shprehur ne mije leke)

Pershkrimi	31.12.2011	31.12.2010
<b>Fluksi monetar nga veprimtaria e shfrytezimit</b>		
Fitimi para tatimit	939,371	1,517,624
Rregullime per:		
Tatimi Fitimin e njohur ne PASH	(220,592)	(314,454)
Shpenzime per interesa te njohura ne PASH		
Provizione te tjera	399,560	350,533
Amortizimi i Aktiveve Afat gjate	1,418,825	1,424,519
Te ardhura (Humbje) nga kembimet valutore		
<b>Ndryshimet ne Flukset e MM nga aktiviteti i shfrytezimit</b>	<b>2,537,165</b>	<b>2,978,222</b>
Rritje/renie e kerkesave te arketueshme	(912,641)	5,473,457
Rritje/renie e tepricave te inventarit	103,520	(55,770)
Rritje/renie ne shpenzimet e shtyra		
Rritje/renie ne llogarite e furnitoreve	1,178,831	(1,188,191)
Rritje/renie ne llogarite e tjera te pagueshme	(158,848)	159,163
Rritje/renie ne parapagime te ardhura te shtyra	39,300	36,562
<b>MM Neto nga aktivitet e shfrytezimit</b>	<b>250,161</b>	<b>4,425,221</b>
<b>Fluksi monetar nga veprimtaria e investimit</b>	<b>(2,097,155)</b>	<b>(969,038)</b>
Pagesa per blerje AAM	(2,085,261)	(969,038)
Pagesa per blerje AAJM	(11,893)	-
<b>Fluksi monetar nga veprimtaria e financiare</b>	<b>(1,962,106)</b>	<b>(6,037,568)</b>
Rritje/renie ne llogarite e kerkesave per arketim afat gjate	14,102	(5,325,132)
Rritje/renie ne huamarrje afat gjate	(1,976,208)	(712,436)
<b>Rritja /renia neto e mjeteve monetare</b>	<b>(1,271,934)</b>	<b>396,837</b>
Paraja dhe ekuivalenteve te saj ne fillim te vitit	1,428,705	1,031,868
<b>Paraja dhe ekuivalenteve te saj ne fund te vitit</b>	<b>156,772</b>	<b>1,428,705</b>

Shenimet shoqeruese jane pjese integrale e ketyre pasqyrave financiare.



Handwritten signatures and initials in blue ink, including a signature that appears to be 'MB' and another that appears to be 'MB'.

**PASQYRA E LEVIZJES SE KAPITALEVE TE VETA**  
Per ushtrimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2011

(Shumat jane shprehur ne mije leke)

Kapitalet e veta	Shprehur ne 000/Leke				Totali
	Kapitali Aksioner	Rezerva rivleresimi	Rezerva Ligjore	Rezultati i mbartur ushtrimit	
<b>Gjendja me 31 Dhjetor 2010</b>	<b>15,000,000</b>	<b>23,153</b>	<b>232,302</b>	<b>903,576</b>	<b>17,362,200</b>
Efkti i ndryshimit ne politikat kontabel				1,203,169	
<b>Pozicioni i rregulluar</b>	<b>15,000,000</b>	<b>23,153</b>	<b>232,302</b>	<b>903,576</b>	<b>17,362,200</b>
Fitimi neto I periudhes				718,780	718,780
Dividende te paguar/deklaruar					
Transferime ne rezerven e detyrueshme ligjore					
Transferime ne rezerven e detyrueshme statutore					
Transferime ne rezerva te tjera					
Emitim i kapitalit aksioner					
Rezerva rivleresimi I AAM					
Transferim ne detyrimet					
Transferime nga rezervat per zmadhim kapitali					
<b>Gjendja me 31 Dhjetor 2011</b>	<b>15,000,000</b>	<b>23,153</b>	<b>232,302</b>	<b>903,576</b>	<b>18,080,980</b>

Pasqyrat Fianciare te vitit 2011 u aprovuan nga manaxhimi i shoqerise dhe u firmosen ne emer te tij 30 Mars 2012 nga:

P/ ORHAN COSKUN

Drejtor i Pergjithshem

Myrvete FERHATI

Dr/ Drejtorise Ekonomike



**SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE**

**1. Informacion i Pergjithshem**

“ALBTELECOM” SH.A. eshte rregjistruar si shoqeri aksionere me Vendim te Gjykates se Rrethit Tirane, numer 20820 date 18.02.1999, te Rregjistrimit Tregtar, ne perputhje me ligjin Nr 9901 Dt 14.04.2008 “ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”.

Kapitali i shoqerise eshte 15,000,000 mije leke.

Shoqerise ofron nje game te gjere sherbimesh te tilla si: sherbimi i telefonise fikse, Interkoneksionit per operatore te tjere, Internetit, sherbimit ADSL, ISDN, linjave me qera, kartave te parapaguara dhe sherbimeve te tjera te telekomunikacionit.

Keshilli Mbikqyres aktual dhe organet drejtuese te shoqerise jane:

Keshilli Mbikqyres:

<u>Emri</u>	<u>Funksioni</u>	<u>Vendodhia</u>
<b>Ahmet Calik</b>	Kryetar	Turqi
<b>Bahadir Aksoy</b>	Zv. Kryetar	Tirane
<b>Mehmet Taylan</b>	Anetar	Suedi
<b>Izzet Ferhat Demir</b>	Anetar	Turqi
<b>Kamil Gorkan Bozkurt</b>	Anetar	Turqi
<b>Mehmet Ertugrul Gurler</b>	Anetar	Turqi
<b>Dorjan Ducka</b>	Anetar	Tirane

Organet Drejtuese:

<u>Emri</u>	<u>Funksioni</u>	<u>Vendodhia</u>
<b>Orhan COSKUN</b>	Drejtor I Pergjithshem	Tirane
<b>Omer Kerem Ozkakil</b>	Zv. Drejtor I Pergjithshem	Tirane
<b>Abdulahap Yeroglu</b>	Zv.Drejtor I Pergjithshem	Tirane

Selia e shoqerise eshte Rruga Myslym Shyri Nr. 42 Tirane. Shoqeria eshte e regjistruar si person juridik ne Degen e Tatimpaguesve te Medhenj me License No. 3898113 dhe NIPT J 61824053 N.

Per qellime te menaxhimit, aktualisht shoqeria eshte e organizuar ne fusha biznesi. Ne vitin 2010 Albtelecom vuri ne funksionim programin financiar SAP dhe ne sistem paraqiten shpenzimet dhe te ardhurat sipas fushave te biznesit.

Organizimi i Shoqerise Albtelecom eshte si me poshte:

- Drejtoria e Pergjithshme
- Rajone te klasit A 6 rajone
- Rajone te klasit B 2 Rajone
- Rajone te klasit C 3 Rajone
- Zona Albtelecom 7
- Zyra Albtelecom 45



## 2. Baza e përgatitjes së pasqyrave Financiare

### a. Bazat e përgatitjes

Pasqyrat Financiare janë përgatitur në përputhje me rregullat dhe interpretimet e ligjit Nr 9228 datë 29 Prill 2004 "Mbi Kontabilitetin" dhe Standardet Nderkombetare të Raportimit Financiar (SNRF) të aprovuara nga Keshilli Kombëtar i Kontabilitetit (KKK).

### a. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare të shoqërisë janë përgatitur mbi bazën e kostos historike, me përjashtim të rasteve që përcaktohet ndryshe në shënimet në vijim.

### b. Ndryshime në politikat kontabel

Shoqëria zbaton SNRF. Nuk ka ndryshime në politikat kontabel krahasuar me periudhën e mëparshme.

### c. Monedha raportuese dhe ajo funksionale

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e shoqërisë.

Të gjitha informacionet financiare të paraqitura në LEKE janë rrumbullakosur në mijeshen më të afërt (përveçse kur deklarohet ndryshe).

### d. Vlerësime dhe gjykime

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtuesit të ushtrojnë gjykimin e tyre në procesin e zbatimit të politikave kontabel të Shoqërisë dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga keto vlerësime.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Efekte që rrjedhin nga rishikimet e vlerësimeve kontabel njihen në periudhën në të cilën keto vlerësime janë rishikuar si dhe në cdo periudhë të ardhshme.

Në vecanti, informacion mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabel të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumën e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare.

## 3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabile

### a. Instrumentat Financiare

Instrumentat financiarë jo-derivativë të shoqërisë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, likuiditete dhe vlera arke të tjera, hua të marra dhe të dhëna, dhe llogari të pagueshme.

#### ✓ Njohja fillestare dhe çregjistrimi

Një instrument financiar njihet nëse shoqëria bëhet palë e kushteve kontraktuale të instrumentit në fjalë. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç rasteve siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në shpenzime dhe të ardhura.

Aktivitet financiarë çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë përfundojnë, skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.



*Handwritten signature*



✓ **Njohja e metejshme**

**Paraja dhe ekuivalentët e parasë**

Paraja dhe ekuivalentët e parasë (mjetet monetare) përfshijnë tepricat e arkës, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllime të pasqyrës së fluksit të parasë, paraja dhe ekuivalentët të saj përfshijnë depozita pa afat dhe ato me një maturimi prej tre muajsh ose më pak që nga data fillestare. Likuiditetet dhe vlera arke të tjera maten me tej me koston e amortizuar pakesuar me humbjet nga zhvleresimet.

**Huate dhe Llogari të arkëtueshme**

Huate e dhena dhe Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Llogarite e arketueshme afatshkurtra nuk skontohen.

**Llogari të pagueshme**

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv nese eshte materiale.

**Hua të marra dhe të dhëna**

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht me vlerën e drejte, pa perfshire koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diference midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar në interesin efektiv. Kostot e huadhenies kapitalizohen si pjese e koston se nje aktivi qe kerkon domosdoshmerisht nje periudhe te rendesishme per t'u pergatitur per perdorimin e destinuar apo shitjen e tij. Fitimet dhe humbjet njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve kur aktivet dhe detyrimet financiare te mesiperme zhvleresohen sikurse dhe nepermjet procesit te amortizimit.

✓ **Zhvleresime te aktiveve financiare**

Nje aktiv financiar konsiderohet si i zhvleresuar ne ato raste kur ekzistojne kushte objektive qe tregojne se nje apo me shume ngjarje (pas njohjes se tij fillestare) kane efekte negative ne flukset e ardhshme te parase qe parashikohet të burojnë prej atij aktivi. Veshitresite e konsiderueshme financiare te debitorit, probabiliteti qe debitori do te falimentoje apo nje riorganizim financiar, dhe pamundesia apo shkeljet ne pagesa konsiderohen si tregues qe nje llogari e arketueshme eshte e zhvleresuar.

Aktivitet e rendesishme financiare testohen ne menyre individuale per zhvleresim. Aktivitet e tjera financiare vleresohen në mënyrë të grupuar, mbi baze grupesh që kanë karakteristika të ngjashme të riskut financiar.

Humbja nga zhvleresimi lidhur me nje aktiv financiar te matur me kosto te amortizuar, llogaritet si diferenca midis vleres kontabel te aktivitet dhe vleres aktuale te flukseve te ardhshme te parase, te skontuara me normen efektive te interesit te aktivitet. Vlera e nje aktivi zvogelohet nepermjet llogarise per zhvleresime dhe vlera e humbjes nga zhvleresimi njihet ne pasqyren e e te ardhurave dhe shpenzimeve.

Te ardhurat nga interesi vazhdojne te rriten mbi vleren kontabel te aktualizuar, bazuar ne normen origjinale efektive te aktivitet. Llogarite e arketueshme se bashku me fondin rezerve te zhvleresimit qe i shoqeron c' regjistrohen atehere kur nuk ka shpresa per rikuperim real ne te ardhmen.

Vlera e mbetur e aktiveve jo-financiare të shoqërisë, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna për zhvlerësim. Nëse ka të dhëna të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitet. Nese ne nje vit pasues, shumta e humbjeve te vleresuara nga zhvleresimi rritet apo ulet per shkak te nje ngjarje pas njohjes fillestare te aktivitet, humbja nga zhvleresimi i njohur me pare rritet apo reduktohet duke rregulluar llogarine e fondit rezerve te zhvleresimeve. Nese nje aktiv i cregjistruar me pare, rikuperohet, ky rikuperim njihet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

✓ **Zhvleresimi I Aktiveve jo-financiare**

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbetur e një aktivi tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.



8

*[Handwritten signatures]*



✓ **Netimi i instrumentave financiare**

Aktivitet dhe pasivitet financiare netohen dhe shuma neto e tyre raportohet ne bilanc nese, dhe vetem nese ka nje te drejte te detyrueshme ligjore per te netuar shumen e njohur dhe ekziston mundesia per te shlyer ne shumen neto, apo per te realizuar aktivin dhe shlyer pasivitet njekohesisht. Kjo vlen kryesisht per balancat ndaj/dhe nga operatorët e tjere te telekomunikacioneve kombetare dhe nderkombetare, te cilat shlyhen ne shumen neto, ne perputhje me kontratat ekzistuese.

✓ **Percaktimi i Vleres se Drejte**

Vlera e drejte e parase dhe e likuiditeteve, llogarive te arketueshme dhe llogarive te pagueshme jane afersisht te barabarta me vleren kontabel te dhene, per shkak te maturimit te tyre afatshkurter.

✓ **Të tjera**

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

✓ **Kapitali aksioner**

Kapitali aksioner njihet me vlerën nominale.

**b. Inventari**

Inventari paraqiten me vleren me te ulet mes koston dhe vleres se realizueshme neto. Vlera e realizueshme neto eshte çmimi i shitjes i perlllogaritur gjate rrjedhes normale te biznesit, pa koston e perlllogaritur te perfundimit dhe shpenzimet e shitjes. Kostot e inventarit jane perlllogaritur duke u bazuar ne metoden e mesatares se ponderuar dhe perfshin shpenzimet e kryera gjate blerjes se inventarit dhe e dergimit te tyre ne kushtet dhe vendodhjen ekzistuese

**c. Investime ne pjesemarrje**

Investimet ne pjesemarrje fillimisht njihen me kosto. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e pjesemarrjes ne fjale.

**d. Aktivitet Afatgjata Materiale (AAM)**

✓ **Njohja dhe matja**

Zerat e llogarise toka, ndertesa, makineri dhe pajisje te telekomunikacionit jane te paraqitura me vleren e drejte duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Te gjitha aktivitet e tjera afat-gjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitet. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitet në gjëndje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes si në gjëndjen e mëparshme të vendodhjes së aktivitet.


Kostoja e aktiveve te kualifikuara përfshin koston e interesit te kryera gjate periudhave te ndertimit, nese ka, bazuar ne normen mesatare te matur te huadhenies.

Software i blere qe eshte thelbesor per funksionimin e pajisjes perkatese kapitalizohet si pjese e asaj pajisje.

Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitet kur përfundon ndertimi tij.

Në rastet kur pjesë të një aktivitet afat-gjate materiale kane jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentet më të mëdhenj) të aktiveve afat-gjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur, dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave.



9

*[Handwritten signatures]*



✓ **Kostot e mëpasshme**

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afat-gjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afat-gjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

✓ **Amortizimi**

Amortizimi i aktiveve llogaritet mbi jetën e vlerësuar të cdo pjese të aktivitetit afat-gjate material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Amortizimi kalohet në pasqyrën e të ardhurave e shpenzimeve.

Normat vjetore të amortizimit të përdorura, bazuar në Ligjin 8438 datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave No.5 datë 30.01.2006 janë si më poshtë:

Aktivet afatgjata materiale	Norma e amortizimit %		Metoda e llogaritjes
	2011	2010	
Ndertesa	5	5	Vlera e mbetur
Instalime Teknike ( Linja)	5	5	
Makineri e paisje	20	20	
Mjete transporti	20	20	
Mobilje orendi	20	20	
Pajisje elektronike	25	25	

Amortizimi nuk aplikohet për tokën dhe punimet në proces që nuk janë në funksionim.

Amortizimi i aktiveve afatgjata materiale përlogaritet mbi bazën e jetës ekonomike të dobishme mesatare. Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në cdo datë raportimi dhe ndryshohen në rast se efektet janë materiale.

✓ **Vlera e drejte**

Shoqëria i paraqet AAM në bilancin e vitit 2011 me vlerën e drejte.

✓ **C'regjistrimi**

Nje ze i aktiveve afatgjata materiale cregjistrohet kur ai nxirret jashte përdorimit apo atehere kur nuk priten me përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashte përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashte përdorimit të aktiveve afatgjata materiale përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të ushtrimit.

**e. Aktivet afatgjata Jomateriale**


Aktivitetet afatgjata jomateriale përfshijnë licensat, të drejtat për përdorim dhe emri i mire.

✓ **Njohja dhe Matja**

Licensat, të drejtat e përdorimit të cilat përftohen nga shoqëria paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar (shihni më poshtë) dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi, nëse ka.

✓ **Shpenzimet pasuese**

Shpenzimet pasuese kapitalizohen vetëm në rastin kur shtojnë përfitimet e ardhshme ekonomike të trupezuara në aktivin specifik me të cilat ato lidhen. Të gjitha shpenzimet njihen si fitim apo humbje në momentin kur kryhen.





✓ **Amortizimi**

Amortizimi njihet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve duke perdorur metoden lineare mbi jetegjatesine e parashikuar te aktiveve te patrupezuara qe nga data qe jane te disponueshme per perdorim. Jetegjatesia e parashikuar e aktiveve per periudhat aktuale dhe krahasuese eshte si me poshte:

Liçensat dhe te drejtat e perdorimit

3-7 vjet

**f. Zhvleresimi (Renia ne vlere)**

Shoqeria vlereson ne çdo date raportimi nese ka premisa qe nje aktiv te zhvleresohet. Ne rast se evidentohet mundesia per zhvleresim, atehere vleresohet vlere e rikuperueshme e aktivitetit. Per aktivet e patrupezuara qe nuk jane te gatshme per perdorim, vlere e rikuperueshme perlogaritet ne çdo date te bilancit.

Nje zhvleresim njihet atehere kur vlere kontabel e nje aktiv apo vlere e flukseve qe do te gjeneroje, eshte me e madhe se vlere e rikuperueshme e aktivitetit. Vlere e flukseve qe gjenerohen eshte grupi me i vogel i identifikueshem i aktiveve qe gjeneron flukse te parase qe jane kryesisht te pavarur nga aktivet dhe grupet e tjera. Humbjet nga zhvleresimet njihen ne pasqyren e fitimeve dhe humbjeve. Vlere e rikuperueshme e nje aktiv apo nje njesie qe gjeneron flukse paraje eshte me e madhe midis vleres se tij ne perdorim dhe vleres se drejte e tij, minus kostot e shitjes. Per te vleresuar vleren ne perdorim, flukset e ardhshme te parashikuara te parase aktualizohen nga vlere e tyre ekzistuese duke perdorur nje norme aktualizimi pa llogaritur tatimet, e cila reflekton vleresimet aktuale te tregut te vleres monetare ne kohe dhe rreziqet specifike qe kane lidhje me ate aktiv.

Humbja nga zhvleresimi kthehet nese ka indikator qe kjo humbje nuk ekziston me dhe ka pasur nje ndryshim ne perlogaritjet e perdorura per te percaktuar shumen e rikuperueshme. Nje humbje nga zhvleresimi kthehet vetem deri ne shkallen qe gjendja e mbartur e aktivitetit nuk eshte me madhe se gjendja e mbartur qe do te ishte percaktuar, neto e zhvleresimit dhe amortizimit, ne rast se nuk ka qene njohur asnje humbje nga zhvleresimi.

**g. Huate**

Huate e marra cash nga institucionet financiare nga shoqeria, jane mbajtur me koston e amortizuar duke perdorur interesin e aplikuar ne kontratat e huave. Interesat e perlogaritura jane njohur ne pasqyren e te ardhura-shpenzimeve dhe si detyrim ne llogarinet e interesave te perlogaritura.

**h. Marrja me qera**


Marrjet me qira (Qirate) klasifikohen si qira financiare (kapitali) ose qira operative qe ne fillimin e qirase. Qirate e financave (kapitalit) njihen si aktive dhe detyrime financiare ne shkallen me te ulet te vleres se drejte te aktivitetit dhe vleres aktuale te minimumit te pagesave te qirase ne daten e blerjes. Kostot e financiare regjistrohen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve nen termin e qirase me normat e zbatueshme te interesit mbi balancen e mbetur te detyrimeve.

**i. Grantet qeveritare**

Grantet qeveritare (Subvencione per Investime) qe kompensojne Shoqerine per koston e nje aktiv skontohen nga shumata e mbartur e aktivitetit ne rastin kur ekziston nje norme e arsyeshme sigurie qe ajo do te merret dhe qe Shoqeria do te veprojë ne perputhje me kushtet perkatese. Grantet qeveritare qe kompensojne Shoqerine per koston e nje aktiv njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve duke zvogeluar shpenzimet respektive te amortizimit me nje baze sistematike mbi jetegjatesine e dobishme te aktivitetit.

**j. Provizionet**

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar (nese eshte materiale) flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen ne çdo date bilanci dhe nese nuk ka me gjasë per daljen e ndonje fluksi parash per shlyerjen e detyrimit, provizionet kthehen. Provizionet perdoren vetem per qellimin qe jane njohur fillimisht. Ato nuk njihen per humbjet e ardhshme operative. Aktivet e kushtezuara nuk njihen por paraqiten ne shenime kur jane sinjifikative.



*[Handwritten signature]*



**k. Konvertimi i monedhave te huaja**

Transaksionet ne monedhe te huaj jane konvertuar ne monedhen funksionale me kursin e kembimit te dates ne te cilin eshte kryer transaksioni. Aktivitet dhe pasivet monetare ne monedhe te huaj ne daten e mbylljes se bilancit jane rivleresuar ne monedhen funksionale sipas kursit te shpallur nga Banka e Shqiperise ne daten e mbylljes se periudhes ushtrimore. Diferencat qe rrjedhin si rezultat i rikonvertimit njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset zyrtare te kembimit per monedhat kryesore te perdorura ne konvertimin e gjendjeve te bilancit emertuar ne monedhe ne huaj në datën e hartimit të bilancit jane si me poshte (ne LEK):

<u>Monedha</u>	<u>31 Dhjetor 2011</u>	<u>31 Dhjetor 2010</u>
1 EUR	138.93	138.77
1 USD	107.54	104.00
1 SDR	164.58	160.16

**l. Të ardhurat – Njohja e te ardhurave**

**Sherbimet**

Te ardhurat nga sherbimet regjistrohen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve ne proporcion me perfundimin e sherbimit ne daten e raportimit. Te ardhurat nga sherbimet konsistojne ne:

- tarifat e abonimit,
- tarifat e sherbimit telefonik,
- pajtimi mujor dhe sherbime te tjera
- sherbimet e interkonjeksionit.
- Sherbimet e internetit

Te ardhurat nga keto sherbime njihen si me poshte:

**Tarifat nga lidhjet e reja**

Të ardhurat nga lidhja e pajtimtarëve me rrjetin e telefonisë fikse njihen me aktivizimin e shërbimit të telekomunikacionit.

**Sherbimi telefonik, pajtimi mujor dhe tarifa te tjera**

Sherbimi telefonik bazohet ne trafikun e krijuar nga koha bisedore e kryer nga abonenti, tarifa e aplikuar, destinacioni i thirrjes dhe lloji i sherbimit. Tarifat e sherbimit telefonik varen nga trafiku, koha e bisedes se perdorur apo volumi i te dhenave te transmetuara per sherbimet me vlere te shtuar, perdorimi i internetit dhe sherbimet e te dhenave. Te ardhurat nga sherbimi telefonik dhe sherbimet me vlere te shtuar njihen ne periudhen kur sherbimet ofrohen. Te ardhurat e pafaturuara nga cikli i faturimit qe daton ne fund te çdo muaji, perlogariten ne baze te trafikut dhe regjistrohen ne fund te muajit.

**Shitja e Kartave te parapaguara**

Te ardhurat nga shitja e kartave rimbushese me parapagese dhe kohes se bisedes per sherbimin me parapagese, neto nga uljet e lejuara, te perfshira ne paketat e sherbimit me parapagese te Shoqerise, njihen ne momentin e shitjes. Nuk behet ndonje axhustim lidhur me koha e paperdorur e bisedes e ofruar.





### **Sherbimi i Interkoneksionit**

Te gjitha thirrjet qe kane nje numer Albtelekom si numer terminimi dhe abonentin e nje shoqerie tjeter si numer origjinues, krijojne nje marredhenie te ardhurash midis ALBTELECOM-it dhe shoqerise tjeter. Keto te ardhura njihen si te ardhura interkoneksioni mes dy shoqerive.

Te ardhurat e Interkoneksionit burojne nga te gjitha thirrjet qe terminojne ne rrjetin e ALBTELECOM-it nga rrjete te operatoreve te huaj, vendas, fiks dhe celular.

Te gjitha thirrjet qe kane nje numer ALBTELECOM si numer origjinues dhe abonentin e nje shoqerie tjeter si numer terminues, krijojne nje marredhenie kostoje midis shoqerise tjeter dhe ALBTELECOM-it. Kjo kosto njihet si kosto interkoneksioni mes dy shoqerive. Kostot e Interkoneksionit burojne nga te gjitha thirrjet e origjinuara ne rrjetin e ALBTELECOM-it dhe te terminuara ne rrjete te operatoreve te huaj, vendas, fiks dhe celular, duke perdorur rrjetet e shoqerive. Shoqeria ju paguan operatoreve te tjere nje pjese te te ardhurave qe mbledh nga thirrjet e abonenteve te vet per te gjitha thirrjet drejt rrjeteve te ketyre operatoreve te tjere te huaj, vendas, fiks dhe celular. Keto te ardhura (dhe shpenzime) njihen ne pasqyren e te ardhurave ne kohen kur thirrja merret/pranohet ne rrjetin e Shoqerise (dhe ne rrjetin e operatorit tjeter perkatesisht)

### **Sherbimet e Internetit**

Sherbimet e internetit perfaqesojne te ardhura qe shoqeria realizon nga ofrimi i sherbimit ADSL per abonentet familjare dhe biznesi ,sherbimin LAN to LAN per shoqerite private dhe shteterore si dhe sherbimin e internetit per perdoruesit e Internetit ( IP).

### **Mallrat**

Te ardhurat nga shitja e aksesoreve, neto nga uljet e lejuara, njihen ne momentin e dorezimit te mallrave kur e drejta e pronesis dhe rreziku i humbjes i kalojne klientit.

### **Linjat e dhena me qira**

Shoqeria jep me qira linja kryesisht operatoreve mobile ne menyre qe rrjeti i tyre te lidhet me rrjetin fiks te Albtelekom Sh.a.. Te ardhurat fikse te qerases per keto linja njihen ne baze te metodës lineare mbi kushtet kontraktuale te qerases. Te ardhurat nga qirate operative njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve ne baze te metodës lineare sipas kohezgjatjes se qerases.

### **Te Ardhurat dhe shpenzimet Financiare**

Te ardhurat dhe shpenzimet nga interesat njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve kur akumulohen, duke marre parasysh metoden e interesit efektiv.

Shpenzimet per interesa perfshijne interesin e pagueshem mbi borxhet e marra per qellime te kapitalit te punes, te perlllogaritur me metoden e normes efektive te interesit.


#### **m. Tatimi mbi fitimin**

Tatim fitimi apo humbjet e vitit perbehet nga tatimi aktual. Tatim fitimi njihet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve pervec rasteve kur lidhet me zera qe njihen direkt ne kapital, rast ne te cilin edhe tatimi njihet ne kapital. Tatimi aktual eshte tatimi i pritur per t'u paguar mbi fitimin e tatueshem te vitit, duke aplikuar normat tatimore ne fuqi ne daten e bilancit, si edhe çfaredolloj rregullimi kontabel te tatimit per t'u paguar ne lidhje me vitet e meparshme.

Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2011 eshte 10%

#### **n. Fondet per pensione**

Shoqeria paguan ne emer te saj dhe te punonjesve kontributet per pensione si edhe kontribute per sigurim shendetsor per punonjesit e saj sic eshte parashikuar nga legjislacioni ne fuqi. Kontributet e llogaritura ne emer te Shoqerise ngarkohen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve ne momentin qe ato ndodhin.





**o. Palet e lidhura**

Pale te lidhura jane ato, kur njera prej paleve kontrollohet nga pala tjeter ose ka influence te rendesishme ne vendimarrjen financiare ose te biznesit te pales tjeter. Per qellim te shpalosjes ne pasqyrat financiare, vetem ortaku i Shoqerise do te konsiderohet pale e lidhur.

**p. Ngjarje pas dates se bilancit**

